



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO  
KOMUNA E GJAKOVËS  
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA

## Njësia e Prokurimit

Gjakovë, datë 27.04.2021

1. Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjakovës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullës për Parashtrimin e Ankesave të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 26.04.2021, të parashtruar nga Operatori Ekonomik “D&T group”sh.p.k”, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Furnizim me një automjet për transport të pacientëve të dializes, me Nr. të Prok: 632-21-1175-121, Nr. Brendshëm 632-21-019-121, nxjerr:

### V E N D I M

1. **Refuzohet** kërkesat për ri-shqyrtim e Operatorit Ekonomik “D&T group”sh.p.k”, të dt. 26.04.2021, lidhur me aktivitetin e prokurimit Furnizim me një automjet për transport të pacientëve të dializes, me Nr. të Prok: 632-21-1175-121, Nr. Brendshëm 632-21-019-121., kundër Njoftimit MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES , te AK –së, të datës 22.04.2021, të publikuar në platformën elektronike të KRPP-së .
2. Vërtetohet NJOFTIM MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES të publikuar me datë: 22.04.2021;
  1. Autoriteti Kontraktues, vendos që te vazhdoj me aktivitetin e prokurimit;
  2. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të ju dorëzohet palëve/

## Arsyetim

- I. **Operatori Ekonomik "D&T group" sh.p.k**, me datë 26.04.2021, kanë parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me **Furnizim me një automjet për transport të pacientëve të dializes, me Nr. të Prok: 632-21-1175-121, Nr. Brendshëm 632-21-019-121.**

Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës, me datë 27.04.2021, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Pretendimi juaj se: keni sjellur katalogun e automjetit dhe çdo gjë është specifikuar në katalog, nuk qëndron sepse në Dosjen e tenderit dhe Njoftimin për kontratë, është kërkuar që katalogu të jetë i **nënvizuar**, kusht i cili nuk është plotësuar në ofertën tuaj prandaj pretendimi juaj është i pabazuar.

Operatori Ekonomik duhet të dorëzoj katalogun me fotografi me nënvizim me një përshkrim detal të produktit nga prodhuesi

Katalogun me përshkrim detal të produktit (kopje)

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si ne dispozitiv.

### **Këshilla juridike:**

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së . **Ankesa pranë OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij vendimi.**

Kopje: Operatorit Ekonomik;  
Zyrës së Kryetarit të Komunës;  
Te gjitha palëve te interesuara;

Arkivit të Komunës

Faton Gutaj  
Menaxher i Zyrës së Prokurimit

